



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.10, datë 16.01.2023

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Asllan Barjamaj, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.
2. Zoti Asllan Barjamaj do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, nga data 28.01.2023 deri më 27.04.2023.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Asllan Barjamaj do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Asllan Barjamaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza